

MARREVESHJE
DATË 18.06.2024
PER
BASHKIMIN ME PËRTHITHJE TË SHOQERIVE :

“PROFESSIONAL MARKETING ALBANIA” SHPK

Kapitali 23 830 000 leke

Selia : Në Tiranë , Rruga e Elbasanit,
Objekti "Park Gate", Kati i I-rë,
Tiranë, Shqipëri

PËRTHITHËSE

“PROM FB” SHPK

Kapitali 1 000 leke

Selia: Në TIRANE Njesia Bashkiake nr.5,
Rruga Sami Frasheri, Pallati 20/1, Ap.1
Tiranë, Shqipëri

E PËRTHITHUR

Shoqerite tregtare **PROFESSIONAL MARKETING ALBANIA” SHPK Tirane**, regjistruar si person juridik me date date 05.10.2011 me NIPT L51616009E dhe e perfaqesuar nga Administratori Z. Albert Koka dhe **“PROM FB” SHPK Tirane** , regjistruar si person juridik me date 16.04.2015 me NIPT L51616009E dhe perfaqesuar nga Administratori Z. Ermand Hysi, sot me daten 18.06.2024, ne vijim te depozitimit te Projekt-Marreveshjes se Bashkimit me Perthithje prane QKB ne daten 14.10.2022 si dhe ne vijim te Raportit Perfundimtar te Kontrollit Tatimor nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane Nr.Prot 51241/1 Date 07.02.2024 hartojne kete Marreveshje per Bashkimin me Perthithje te tyre sipas procedurave ne vijim :

1. Drejtimi i bashkimit

“PROFESSIONAL MARKETING ALBANIA” SHPK Tirane do te jete Shoqeria Perthithese e shenuar ne vijim edhe si **shoqeria perfituese** e kontributeve, ndërsa **“PROM FB” SHPK Tirane** do te jete shoqeria e Perthithur, e shenuar ne vijim edhe si **shoqeri kontribuese**.

2.Qellimi i Bashkimit

Grupim i forcave dhe i mjeteve per te rritur efektshmerine e perdorimit te tyre ne funksion te rritjes se perfitueshmerise.

3. Aktivet dhe pasivet (detyrimet) e parashikuara per t’u transferuar

Ne kuadrin e ketij operacioni bashkimi, **“PROM FB” SHPK** do t’i kaloje Shoqerise **“PROFESSIONAL MARKETING ALBANIA” SHPK** teresine e elementeve te aktivitet

 

dhe te pasivit sipas bilancit date 31.12.2021, duke perfshire edhe ato qe rezultojne nga operacionet e kryera nga 1 Janar 2022 e deri në datën e hyrjes ne fuqi te ketij operacioni.

- 2 -

4. Modalitetet e bashkimit

“PROFESSIONAL MARKETING ALBANIA” SHPK Tirane do te jete zoteruese e aktiveve dhe te drejtave si dhe merr persiper detyrimet e krijuara nga shoqeria **“PROM FB” SHPK** Tirane deri ne daten e realizimit perfundimtar te bashkimit. Ajo gezon frutet e kontributit duke filluar nga 1 Janar 2022, me kushtin e realizimit te bashkimit ne fjale.

Kapitali i Regjistruar i shoqerise **“PROFESSIONAL MARKETING ALBANIA” SHPK** , dhe ai i **PROM FB” SHPK** zoterohen teresisht nga Z. Marin GJONAJ , duke mos pasur ndryshime edhe pas ketij bashkimi e per rredhoje Ortak i Vetëm i shoqerise perthithese mbetet Z. Marin GJONAJ

Ne kushtet qe vlefte e nje kuote te shoqerise **“PROFESSIONAL MARKETING ALBANIA” SHPK** 23 830 000 leke , dhe ajo e **“PROM FB” SHPK** eshte 1 000 lekë **Raporti i Kembimit** eshte llogaritur duke marre parasysh Aktivin Neto te sejciles shoqeri ne daten e bashkimit.

Aktivi Neto (Aktive-detyrime) i **“PROM FB” SHPK** që kalon ne Shoqerine Perthithese **“PROFESSIONAL MARKETING ALBANIA” SHPK** , më datën 31.12.2021 eshte negativ 39 833 207 leke (për kuotën e kapitalit me vleftë 1000 lekë), nderkohe qe Aktivi Neto i shoqerise Perthithese ne kete date eshte 106 839 808 leke (per 1 kuotë me vleftë 23 830 000 lekë). Ne baze te ketyre treguesve Raporti i Kembimit te nje kuote Kapitali te shoqerive pjesmarrese ne bashkim eshte llogaritur negativ (4,49 me - 39 833). Me kete raport kembimi nuk mbetet ndonje difference e pagueshme ne para.

Duke qene se **Z. Marin GJONAJ** eshte Ortak i Vetëm ne Shoqerine e Perthithur **“PROM FB” SHPK** si dhe në Shoqerine **“GJONAJ GROUP HOLDINGS” SHPK** me NIPT M22010013H qe eshte Ortake e Vetme e Shoqerise Perthithese **“PROFESSIONAL MARKETING ALBANIA” SHPK** (Duke filluar nga data 15.11.2022 eshte ndryshuar Ortaku i Vetem nga Marin Gjonaj ne “Gjonaj Group Holdings SHPK), nuk lindin ndryshime ne ndarjen kuotave, ne te drejta dhe as ne perparesi te veçanta te zoteruesit te Kuotës ne shoqerine perthithese.

Pas ketij Bashkimi Kapitali i Regjistruar i shoqerise **“PROFESSIONAL MARKETING ALBANIA” SHPK**, mbetet i pandryshuar në vleftën 23 830 000 lekë i përbërë nga 1 kuotë që zotërohet nga Ortaku i Vetëm **“GJONAJ GROUP HOLDINGS” SHPK**

Per administratoret, antaret e Keshillit Mbikqyres dhe ekspertet kontabel te shoqerise Perthithese nuk do te kete ndryshime.

Pas ketij bashkimi Administratori i Shoqerise Perthithese mbetet Z.Albert Koka

Nuk do te kete pasoja ndaj punemarresve e perfaqshuesve te tyre per shkak te ketij bashkimi.

- 3 -

5. Data Kontabel

Ne aspektin e kontabilitetit te gjitha operacionet e veprimtarise te kryera prej shoqerise **“PROM FB” SHPK** Tirane nga data 01 Janar 2022 deri ne daten e realizimit te bashkimit do te konsiderohen si te kryera nga **PROFESSIONAL MARKETING ALBANIA” SHPK** Tirane dhe rregjistrimet kontabile perkatese do te merren ne librat kontabile te kesaj te fundit.

6. Data e pergatitjes (hartimit) te llogarive

Llogarite qe do te perdoren per te percaktuar kushtet financiare te bashkimit i u referuar bilanceve te dates 31.12.2021 te hartuara e të deklaruar nga sejcila shoqeri.

7. Te drejta dhe avantazhe te veçanta

Ky operacion bashkimi nuk do te permbaje as te drejta dhe as ndonje avantazh te veçante.

Kjo Marveshje bashkimi hartohet e nenshkruhet me kushtin e varesise se miratimit nga Ortaku i Vetem i shoqerise **“PROFESSIONAL MARKETING ALBANIA” SHPK** Tirane si dhe nga Ortaku i Vetem i shoqerise **“PROM FB” SHPK** Tiranë.

Per shoqerine ,

“PROFESSIONAL MARKETING ALBANIA” SHPK

Perfaqshuar nga Z .Albert KOKA
Administrator

Albert Koka



Rruga e Elbasanit, Çirçësi Park, Kat i 1-le, Tirana NPT L122050341

Per shoqerine ,

“PROM FB” SHPK Tiranë .

Perfaqshuar nga Z. Ermand HYSI
Administrator

Ermand Hysi



Nj. Bashk. 5/Rr. Sami Frashë 20/1, Tirana Albania 51816009E